



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 149

Tiranë – E enjte, 22 gusht 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 5, datë 24.6.2024	Për përcaktimin e rregullave të detajuara, për mënyrën e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional të personave të dënuar me burgim që ndodhen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale..... 18693
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Arkivave nr. 457, datë 20.8.2024	Për delegim kompetencash..... 18695

**UDHËZIM****Nr. 5, datë 24.6.2024****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË DETAJUARA, PËR MËNYRËN E
ZHVILLIMIT TË ARSIMIT DHE
FORMIMIT PROFESIONAL TË
PERSONAVE TË DËNUAR ME BURGIM
QË NDODHEN NË INSTITUCIONET E
EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE
PENALE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 45, pika 9, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit,

UDHËZOJNË:**I. OBJEKTI:**

1. Përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional të personave të dënuar me burgim, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në funksion të përfitimit të njohurive dhe aftësive profesionale, si dhe të riintegrit të tyre në shoqëri.

**II. RREGULLA TË PËRGJITHSHME MBI
ZHVILLIMIN E ARSIMIT DHE FORMIMIT
PROFESIONAL**

1. Arsimi dhe formimi profesional i personave të dënuar me burgim realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin dhe formimin profesional, në përshtatje me kushtet dhe sigurinë e personave të dënuar me burgim që ndjekin arsimin apo formimin profesional.

2. Arsimi dhe formimi profesional i personave të dënuar me burgim ofrohet, për sa është e mundur, në mënyrë të njëjtë si personat që e përfitojnë atë shërbim jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

3. Arsimi profesional ofrohet nëpërmjet ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën.

4. Formimi profesional ofrohet nëpërmjet kurseve profesionale që zhvillohen në ambiente të veçanta, të përshtatura për praktikë profesionale, pranë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

5. Kurset e formimit profesional në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale zbatohen nga ofruesit e formimit profesional publik.

6. Modalitetet e programeve të arsimit dhe formimit profesional që u ofrohen personave të dënuar me burgim duhet të jenë të atilla që të garantojnë sigurinë në institucion të të dënuarve me burgim dhe personelit.

7. Të dënuarit me burgim trajtohen si grupe vulnerabël dhe me prioritet gjatë ndjekjes së procedurave për regjistrimin dhe pjesëmarrjen në arsimin dhe formimin profesional.

8. Të gjithë subjektet që janë të përfshirë në administrimin dhe menaxhimin e sistemit të burgjeve dhe menaxhimin e burgjeve lehtësojnë, dhe mbështesin arsimin e të dënuarve me burgim sa më shumë që të jetë e mundur.

9. Riintegrimi i personave të dënuar me burgim synohet nëpërmjet ndjekjes, edhe pas lirimit, të arsimit profesional apo kurseve të formimit profesional dhe realizohet përmes koordinimit të shërbimeve dhe funksioneve të institucioneve vartëse të ministrive përgjegjëse, 6 muaj përpara lirimit të tyre.

10. Koordinimi zbatohet ndërmjet institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, Shërbimit Social Rajonal dhe ofruesit të arsimit dhe formimit profesional publik.

11. Institucionet marrin masa për t’u mundësuar personave të dënuar me burgim të vazhdojnë arsimimin apo formimin profesional edhe pas lirimit, me qëllim mosndërprerjen e arsimimit apo kursit të ndjekur gjatë ekzekutimit të vendimit penal.

**III. PROCEDURA PËR REALIZIMIN E
ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL
PËR PERSONAT E DËNUAR ME BURGIM**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive janë përgjegjëse për planifikimin, organizimin dhe monitorimin e procesit arsimor, dhe formimit profesional, sipas këtij udhëzimi.

2. Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional për personat e dënuar me burgim bëhet nëpërmjet planifikimit vjetor. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Agjencia Kombëtare Punësimit dhe Aftësive bashkëpunojnë për hartimin e listës emërore të personave të dënuar me burgim që mund ndjekin arsimin apo formimin profesional, bazuar në kushtet e sigurisë dhe programeve të ofruara.



3. Ecuria e procesit arsimor dhe formimit profesional realizohet në përputhje me rregullat e brendshme të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, duke mbajtur parasysh harmonizimin e programit arsimor apo kursit profesional me veprimtaritë e përditshme në institucion.

4. Lista emërore e personave të dënuar me burgim që mund të ndjekin arsimin apo formimin profesional hartohet jo me vonë se 1 (një) muaj përpara fillimit të vitit shkollor apo kursit profesional.

5. Procedura dhe dokumentacioni për regjistrimin dhe pjesëmarrjen e personave të dënuar me burgim në arsim dhe kurset e formimit profesional, deri në përfundimin dhe pajisjen me dokumentacionin përkatës për mbarimin e klasës apo kursit është, për aq sa është e mundur, e njëjtë me procedurën që zbatohet për shtetasit e tjerë që ndjekin arsimin apo formimin profesional jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

6. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve përcaktojnë listën e programeve që mund të ndiqen nga të dënuarit me burgim, si dhe mjetet që mund të përdoren, bazuar në nivelin e sigurisë. Në rastet kur programet përmbajnë lidhje me internetin, kjo lidhje duhet të jetë e kufizuar vetëm për shkaqe mësimore, duke shmangur aksesin e plotë në internet nga të dënuarit me burgim.

7. Institucionet marrin masa për vendosjen në dispozicion të pajisjeve dhe personelin mësimor të nevojshëm për t'u mundësuar personave të dënuar me burgim të marrin kualifikimin e duhur dhe në mënyrë sa më të ngjashme me personat që ndjekin arsimin dhe formimin profesional jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale sipas përgjegjësisë të përcaktuara në pikat 8 dhe 9 të këtij kreu.

8. Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, merr masa për:

a) sigurimin e kushteve, lehtësirave dhe infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e arsimit dhe të kurseve profesionale;

b) vendosjen në dispozicion të mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për ofrimin e arsimit dhe formimit profesional në burgje;

c) sigurimin e shërbimit të nevojshëm psikologjik dhe social, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në mbështetje të pjesëmarrjes

dhe përfundimit me sukses të arsimit dhe kurseve profesionale nga ana e personave të dënuar me burgim, për të asistuar procesin, kur është e nevojshme;

ç) pajisjen me autorizim për personelin që zbaton procesin arsimor dhe formimin profesional, në përputhje me rregullat në fuqi për hyrjen e punonjësve të jashtëm që kryejnë punë në institucion. Pajisja me autorizim bëhet mbi bazën e kërkesës së institucionit të ofrimit të arsimit dhe formimit profesional;

d) vlerësimin vjetor të nevojave buxhetore dhe dërgimin zyrtarisht në Ministrinë e Financave të kërkesave që lidhen me nevojat buxhetore për planifikimin e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, jo më vonë se 3 (tre) muaj përpara përfundimit të vitit buxhetor.

9. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nëpërmjet institucioneve të ofrimit të arsimit dhe formimit profesional, siguron:

a) personelin mësimor dhe mësimdhënësit e formimit teoriko-praktik, në varësi të numrit të personave të dënuar me burgim që ndjekin arsimin dhe formimin profesional, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Kjo listë i dërgohet zyrtarisht institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale në fillim të çdo viti shkollor apo kursi profesional. Për çdo ndryshim të mundshëm të personelit mësimor apo mësimdhënësve të formimit teoriko-praktik, lajmërohet me shkrim drejtuesi i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale;

b) pagesën e personelit mësimdhënës të arsimit dhe formimit profesional për të dënuarit me burgim, që ndjekin arsimin dhe formimin profesional;

c) planet mësimore dhe programet lëndore për arsimin dhe formimin profesional të personave të dënuar me burgim në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;

ç) inspektimin e cilësisë së arsimit dhe formimit profesional në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në përputhje me ligjin për arsimin dhe formimin profesional.

10. Orari javor dhe ditor i zhvillimit të arsimit dhe kurseve të formimit profesional, koha e paraqitjes dhe largimit të personelit, si dhe intervalet e pushimit ndërmjet orëve, janë të njëjta për aq sa është e mundur me zhvillimin e arsimit dhe kurseve të formimit profesional jashtë institucioneve të



ekzekutimit të vendimeve penale. Në rastet kur është e nevojshme të bëhen rregullime të posaçme, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve lidh marrëveshje me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

11. Me mbarimin e nivelit përkatës të arsimit apo kursit profesional, i dënuari me burgim pajiset me dokumentin certifikues, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional, i cili është njësoj i vlefshëm me atë që përfitohet jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale. Ky dokument nuk duhet të tregojë se dokumenti është lëshuar gjatë ekzekutimit të një vendimi penal.

12. Me kërkesën e të dënuarit me burgim, institucioni lëshon vërtetim me të dhëna për aftësimin profesional të fituar gjatë ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe me vërtetim për modulet dhe periudhën që ka ndjekur procesin e arsimit ose të formimit profesional, kur të dënuarit me burgim transferohen në një institucion tjetër penal ose lirohen dhe kur është i pamundur vijimi i ndjekjes së arsimit apo formimit profesional.

13. Personeli që realizon mësimdhënien apo formimin profesional i nënshtrohet ndalimeve apo kufizimeve për vizitorët në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale sipas rregullave në fuqi.

14. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, bashkëpunojnë për ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme me fokus në të drejtat, sjelljen dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim.

15. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe ofruesit e formimit profesional publik caktojnë nga një person kontakti, të cilët do të jenë përgjegjës për zbatimin e marrëveshjeve që do të nënshkruhen në nivel lokal, mbështetur në këtë udhëzim.

16. Personat e kontaktit organizojnë të paktën tri takime të përbashkëta në një vit, për të analizuar ecurinë e procesit të arsimit apo formimit profesional, për të planifikuar për periudhat e riorganizimit dhe për të marr masat e nevojshme për zbatimin e udhëzimit.

17. Në rastet kur institucioni nuk plotëson kushtet për ndjekjen e formimit profesional, drejtori i përgjithshëm i Burgjeve mund të urdhërojë transferimin e tij për shkak të zbatimit të programit të formimit profesional.

18. Kur është e mundur dhe në përputhje me rregullat e sigurisë, të dënuarit me burgim mund të lejohen të marrin pjesë në edukimin jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

19. Në zbatim të këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe ofruesit e formimit profesional publik nënshkruajnë marrëveshje të posaçme që rregullojnë aspekte të bashkëpunimit reciprok për mbarëvajtjen e procesit arsimor apo formimit profesional në institucion.

20. Në marrëveshje përcaktohen programet, kurrikulat, mjetet dhe pajisjet e nevojshme materiale që do të përdoren për ofrimin e arsimit dhe formimit profesional, orari ditor dhe javor i procesit mësimor dhe formimit profesional, koha e paraqitjes dhe largimit të personelit mësimdhënës, intervalet ndërmjet orëve të mësimit apo kursit dhe pushimit, si dhe çdo rregull tjetër që i shërben zhvillimit të procesit.

21. Palët informojnë rregullisht njëra-tjetrën për problemet që do të lindin gjatë zbatimit të këtij udhëzimi dhe marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS
DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

URDHËR
Nr. 457, datë 20.8.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, të ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,



URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të drejtorit të përgjithshëm të Arkivave, z. Endrit Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 21.8.2024 deri në datën 28.8.2024.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve, dhe do t'ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e këtij urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 32 lekë